

**GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala, kryetar i kolegjit, gjyqtareve Mediha Jusufi dhe Gani Avdiu, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridiko civile të paditësit B.M. nga fshati ..., Komuna e Podujevës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.P., avokat me seli në Rr. “Zahir Pajaziti” nr.11 Komuna Podujevë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “X” me seli në Prishtinë, me bazë juridike kompensim i dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, C.nr.423/2011 të dt. 12.11.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 15.07.2016 mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e të autorizuarit të paditurës Kompania e Sigurimeve “X” me seli në Prishtinë, gjersa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, C.nr.423/2011 i dt. 12.11.2013, **VËRTETOHET**.

## **A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, C.nr.423/2011 të dt. 12.11.2013. I. Pjesërisht aprovohet kërkesëpadia e paditësit B.M. nga fshati ..., Komuna e Podujevës, si e bazuar. II. Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “X” sh.a. me seli në Prishtinë, t’ia paguaj paditësit B.M. për aksidentin e dt. 06.12.2011, si pasojë e lëndimeve të pësuarra dhe atë në emër të kompensimit të dëmit material shumë prej 1.800.00 euro, e të gjitha këto me kamatë vjetore siç e paguajnë bankat afariste në Republikën e Kosovës, kursimtarëve të vet në mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar duke filluar nga data e parashtrimit të padisë dt. 20.12.2011, e të gjitha në afatin prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe atë: Në emër të dëmit jo material, në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 900.00 euro, për frikë të përjetuar shumë prej 900,00 euro. Përtej shumë së gjykuar shuma në lartësi prej 100,00 euro, për paditësin B.M. dhe kërkesa për ushqim të sforcuar, për ndihmë dhe kujdes të huaj për rehabilitim klimatik refuzohen si të pabazuara. Detyrohet e paditura Kompania e sigurimeve “X” sh.a. me seli në Prishtinë, që

paditësit t'ia kompensoi në emër të shpenzimeve kontestimore shumë prej 759,00 euro, të gjitha në afatin prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i të paditurës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që aktgjykimi i shkallës së parë të refuzohet dhe të aprovohet në tërësi ankesa e të paditurës si e bazuar.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, të LPK-së, gjeti se:

**- Ankesa është e pabazuar -**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi kundër të paditurës me bazë juridike kompensimi i dëmit. Gjykata e shkallës së parë ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerr provat siç janë: Raporti i aksidentit i përpiluar nga Policia e Kosovës me nr, të rastit 2011-AF-1783 dt.0612.2011 raporti nga QKUK Prishtinë-Qendra emergjente Prishtinë, me nr. të raportit 37574 dt. 06.12.2011, aktmarrëveshja për pranimin e vlerës së dëmit të kërkuar e dt. 0703.2012, urdhër transferi bankar dt. 03.05.2012 për pagesën e dëmit të paditësit për dëmin në bazë të aktmarrëveshjes dt. 07.03.2012 procesverbali i hartuar pranë kësaj gjykate me dt. 18.10.2013, në të cilin procesverbal e kanë dhënë mendimin dhe konstatimin ekspertët mjekësor dhe atë dr. Basri Ibrahimimi-ortoped dhe dr. N.M.-psikiatër, pas ekzaminimit objektiv dhe shkresave të lëndës për paditësin B.M., fletëpagesa e t. 18.10.2013 për kompensimin e ekspertëve të ftuar të bëra nga paditësi B.M., si dhe provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës. Andaj nga provat e cituara më lartë gjykata e shkallës së parë vërtetoi gjendjen faktike dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar duke e aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit dhe njëherit duke e detyruar të paditurën që të kompensoj dëmin material dhe jo material.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, par.2, të LPK-së, dhe se drejtë është aplikuar edhe e drejta materiale e të cilat shkaqe ankimore i vështron gjykata e shkallës së dytë në bazë të detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme, bindëse juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike. Këtë vlerësim Gjykata e Apelit, e mori për shkak se me provat e administruara bindshëm dhe në mënyrë të sigurt është vërtetuar se aksidenti është shkaktuar ekskluzivisht me fajin e të siguruarit të të paditurës me ç 'rast paditësit i është shkaktuar dëmi jo material dhe material. Duke u bazuar në këto prova rrjedh se baza e kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e dëmit material është e themeltë dhe se lartësia e dëmit të gjykuar është në harmoni me kriteret relevante që vlerësohen me rastin e përcaktimit të lartësisë, për arsye se paditësi në bazë të nenit 185, të LMD-së, ka të drejtë në kompensim në të holla për aspektet e

dëmit material. Për çka është lidhur marrëveshja lidhur me kompensimin e dëmit material, në mes të paditësit dhe përfaqësuesit të paditurës. Sa i përket lartësisë së shumës të kompensimit të dëmit jo material gjykata e shkallës së parë me të drejtë u bazua në ekspertizën e ekspertëve Dr. Basri Ibrahim, ortoped dhe Dr.N.M.-psikiatër. Ngase, për tu realizuar shpërblimi i dëmit jo material për shkak të lëndimit trupor duhet të plotësohen këto kushte: duhet të shkactohet lëndimi trupor, lëndimi trupor të shkakttojë dhembje fizike ose vuajtje psikike, të ekzistojë lidhja kauzale midis lëndimit trupor dhe vuajtjeve të shkaktuara fizike si dhe psikike të të dëmtuarit dhe lëndimi trupor duhet të jetë shkaktuar me fajin e dëmtuesit. Këto kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, sepse pa ekzistimin kumulativ të këtyre kushteve nuk mund të realizohet shpërblimi i dëmit jo material. Andaj gjykata e shkallës së parë është mbështetur në mendimin e ekspertëve mjeko-ligjor duke i vërtetuar vuajtjet psikike dhe dhembjet fizike të përcaktuara me intensitet dhe kohëzgjatje të caktuar si në ekspertizën e ekspertëve mjeko-ligjor. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë i ka përcaktuar këto kushte drejtë si dhe e ka përcaktuar shpërblimin e dëmit në mënyrë të saktë dhe sipas kriterëve për përcaktimin e kompensimit të dëmit jo material.

Shpërblimi i dëmit jo material i gjykuar nga gjykata e shkallës së parë është një shpërblim i drejtë në të holla dhe se njëherit kjo lartësi e përcaktuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë lidhur me shpërblimin e dëmit jo material është satisfaksion i të dëmtuarit këtu paditësit, që në një mënyrë paditësit t'ia zbutë atë që ka përjetuar duke pësuar dhembje fizike, vuajtje psikike dhe frikë. Ky satisfaksion nuk është shpërblim adekuat i dëmit, por është tentim i zbutjes së situatës së krijuar të të dëmtuarit me shkaktimin e dëmit. Andaj, gjykata me rastin e përcaktimit të këtij shpërblimi me kujdes ka zbatuar rregullat e shpërblimit të dëmit jo material, vërtetoi faktet relevante për zbatimin e tyre dhe njëherit u bazua në ekspertizën e mjekëve mjeko-ligjor si dhe në super ekspertizë.

Sa i përket pretendimeve ankimore të autorizuarit të paditurës se e paditura ka përmbush obligimin me nënshkrimin e aktmarrëveshjes dhe deklarimi i paditësit se nuk ka asnjë pretendim të mëtutjeshëm financiar ndaj kësaj kompanie, ky pretendim nuk qëndron ngase ky deklarim është bërë lidhur me kompensimin e dëmit material dhe se kjo aktmarrëveshje nuk e precizon se paditësi heq dorë edhe ndaj kompensimit të dëmit jo material. Andaj, me të drejtë gjykata e shkallës së parë nuk e ka marrë për bazë këtë aktmarrëveshje të lidhur në mes të ndërgjyqësve për kompensimin e dëmit material, që nuk ka të bëjë me kompensimin e dëmit jo material.

Kështu duke u bazuar në këto arsye gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit. Meqë aktgjykimi i atakuar nuk përmban të meta të cilat kishin me kontestua ligjshmërinë e këtij aktgjykimi. Dispozitivi i aktgjykimit nuk është në kundërshtim me arsyetimin dhe me provat që gjenden në shkresat e lëndës, që do të thotë se aktgjykimi i ankimuar është i qartë, preciz e konciz dhe si i tillë është dokument i përshtatshëm përmbarues. Nga të cekurat me lartë rezulton se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë.

Duke marr parasysh pretendimet ankimore të cilat konsistojnë ndaj aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendime ankimore janë të pabazuara ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të LPK-së, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194, të LPK-së. Gjithashtu drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale të cilën të drejtë gjykata e shkallës së dytë e vështron sipas detyrës zyrtare.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në kuptim të nenit 195.1, pika d) dhe nenit 200, të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS NË PRISHTINË**

**AC.nr. 4126/2013 datë 15.07.2016**

**KRYETARI I KOLEGJIT-GJYQTARI**

*Hasan Shala*